

FJALA E DEPUTETES GRETA BARDELI

E HËNË 5 DHJETOR 2022

Qeveri e përmbytur, qeveri që përmbyt çfarë gjen përpara. Qeveri e mbytur nga korrupsioni, nga krimi i organizuar, nga droga, nga zyrtarë të inkriminuar, që nuk i mbulon dot as plehu kimik dhe që u del boja edhe matanë oqeanit, është e shkruar e zezë mbi të bardhë në gjitha raportet dhe nga të gjitha agjencitë ndërkombëtare. Po shqiptarët ku janë? Ku është interesi tyre? Ata janë keqpërdorur nga ky Kryeministër, që mbahet në këmbë nga zullumi i pushtetit. Asnjë vendim themelor e plotësisht në interes të qytetarëve të këtij vendi nuk ndërmerr.

Kujtoj se para një jave, në këtë në parlament, u rrëzua amendamenti që siguronte një buxhet modest prej dy miliardë lekësh për përmbytjet në Veri të Shqipërisë, dëmshpërblime për shkodranët dhe lezhjanët, por u rrëzua me arrogancë dhe me urdhër politik, pikërisht nga kjo qeveri, që nuk lë kocensione pa dhënë duke kriminalizuar ekonominë dhe paranë publike. Të nderuar bashkëqytetarë, Pa dyshim, është lajm i mirë që nesër vijnë në Shqipëri udhëheqësit e vendeve të Bashkimit Europian. Ata janë të mirëpritur dhe ne jemi falënderues që nuk e braktisin Shqipërinë dhe Ballkanin Perëndimor.

Besoj fort se ata do të vendosin theksin te çështja e korrupsionit, krimi të organizuar dhe trafikut të drogës, sfida me të cilat Shqipëria duhet të përballet pa asnjë diskutim. Ndërsa çdo protestë e opozitës, në respekt të normave europiane dhe demokratike, është kryefjala dhe reagimi popullor i shqiptarëve ndaj rrënimit shoqëror dhe shpopullimit biblik në këto 10 vjet, me arkitekt Edi Ramën, është reagimi ndaj një oborri kokë e këmbë, simbol kriminal i grabitjes së pasurisë publike. Si anëtare e Komisionit të Jashtëm gjej rastin të shpreh sot, gjithashtu, solidaritetin e plotë me gjithë diplomatët e harruar prej vitesh nëpër zyrat e shtetit, të cilëve nuk u është dhënë mundësia e rritjes në detyrë, sikurse u takon me ligj, duke shkelur çdo standard institucional kombëtar e ndërkombëtar.

Ambasadorët e huaj të vendeve partnere e dinë mirë se çfarë po ndodh dhe po e shprehin në kanale të ndryshme shqetësimin e thellë për këtë fakt. Ju e dini mirë që kemi diplomatë shqiptarë në kancelaritë e jashtme kryesore, që kanë mbi 8 vjet në detyrë apo tashmë kanë dalë në pension dhe janë harruar pa u lëvizur fare, pa u dhënë mundësinë diplomatëve të tjerë të gatshëm, të cilët po lihen të zbehen në zyrat e Ministrisë së Jashtme pa u lëvizur, duke u mohuar të drejtën të ushtrojnë detyrën e tyre. Pra, diplomaci e katandisur keq e me keq, me një qëllim të vetëm, veç të mbijetojë dhe të ngrihet

monumenti i gjallë i zërit tonë ndërkombëtar: “Kryeministri gjigant“, ndërsa të tjerët të katandisen si të pavlerë.

Por kjo s’ka rëndësi për kreun e qeverisë, sikurse prej 10 vjetësh vazhdon të tallet publikisht me pensionistët, me invalidët, me të papunët dhe me familjet që marrin ndihmë ekonomike qesharake. Kjo qeveri u premtoi pensionisteve se do të rriste pensionet me 6%, ndërkohë që inflacioni zyrtar i deklaruar është rritur me 8%, ndërsa shifrat e tjera reale tregojnë se është mbi 11%. Me lekët që morët si shtesa, të gjithë ju, mbi 650 mijë pensionistë, sot blini shumë më pak sesa blinit vite me parë. Kjo është një tallje e madhe dhe mashtrimi më i madh që ju bën sot Kryeministri. Të shtosh pensionet më pak se inflacioni, është shpërdorim detyre.

T’u vjedhësh pensionistëve qoftë edhe një qindarkë të vetme është kriminale. Nëse nuk do të kishte grabitje të pronës publike, koncesione për klientët e Kryeministrit, monopole që kanë kapur ekonominë, korrupsion në dogana dhe tatime, pagesa për inceneratorët dhe të tjera, ato para do të përktheheshin në mundësi financiare reale për pensionistët, për personat me aftësi ndryshe dhe për ata që përfitojnë ndihmën ekonomike. Kështu, pensionistët do të kishin një rritje reale të pensioneve, për një jetesë më të mirë dhe me dinjitet në vendin e tyre.